REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 3478/ 7 prot. Datë 08/01/2026

V E N D I M

Nr. 30/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 08/01/2026, shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik "*Albadent Group*" SHPK në procedurën e prokurimit *"E hapur e thjeshtuar*", me numër reference Nr. *REF-67459-11-03-2025*, me objekt: "*Blerje pajisje laboratorike për Shërbimin e Laboratorit të Anatomo Patologjisë dhe Shërbimin e Bankës së Gjakut"*, me fond limit 9,371,546.33 (*nëntë milion e treqind e shtatëdhjetë e një mijë e pesëqind e dyzet e gjashtë pikë tridhjetë e tre*) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 14.11.2025, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara Sh.A.

Ankimues: Operatori ekonomik "*PEGASUS*" SHPK me NIPT: J62903750A dhe me adresë: *Rruga "Siri Kodra", tek ish frigoriferi, Nr. 149, Tiranë.*

Autoriteti Kontraktor: Operatori i Blerjeve të Përqendruara Sh.A
Adresa: Rruga "Rreshit Çollaku" Godina Nr 6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë).

Persona të interesuar: Operatori ekonomik "*Albadent Group*" SHPK me NIPT: L62217032L dhe me adresë*: Rruga "Allaman Dervishi" Pallati Classic A.M. Nr.31, Kthesa e Kamzës, Tiranë.*

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 *"Për Prokurimin Publik*", i ndryshuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"* i ndryshuar Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 "*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*", Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *"Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19"*.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet 3 (tre) anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar.

I.4. Operatori ekonomik ankimues ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 04.11.2025 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit *"E hapur e thjeshtuar*", me numër reference Nr. *REF-67459-11-03-2025*, me objekt: "*Blerje pajisje laboratorike për Shërbimin e Laboratorit të Anatomo Patologjisë dhe Shërbimin e Bankës së Gjakut",* me fond limit 9,371,546.33 (*nëntë milion e treqind e shtatëdhjetë e një mijë e pesëqind e dyzet e gjashtë pikë tridhjetë e tre*) lekë pa TVSH,

zhvilluar më datë 14.11.2025, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara Sh.A.

II.2. Në datë 14.11.2025 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në datën 19.11.2025 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht mbi klasifikimin përfundimtar të ofertave si vijon:

1	*"BionichTech " shpk*	*me vlerë oferte*	*7.028.659,75*	*leke*	*skualifikuar*
2	*"Albadent Group" shpk*	*me vlerë oferte*	*7.777.007,00*	*leke*	*kualifikuar*
3	*"PEGASUS" shpk*	*me vlerë oferte*	*8.780.000,00*	*leke*	*kualifikuar*

II.4. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronik konstatohet, se në datën 27.11.2025 autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit paraprak për procedurën e mësipërme të prokurimit, duke shpallur fitues shoqërinë *"Albadent Group"* ShPK.

II.5. Në datën 03.12.2025, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe pranë autoritetit kontraktor është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2025/6144 datë 03.12.2025 dhe me numër protokolli nr. 3478/2025 prot, datë 04.12.2025 e operatorit ekonomik "*PEGASUS*" ShPK, me anë të së cilës kundërshtohet vendimmarrja e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik "*Albadent Group*" ShPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.6. Në përputhje me nenin 112 "*Veprimet paraprake*" të Ligjit nr.162/2020 "*Për Prokurimin Publik*", i ndryshuar me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. Prot., 3478/1, datë 04.12.2025 lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues "*PEGASUS*" ShPK, mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik "*Albadent Group*" ShPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.7. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se operatori ekonomik "*Albadent Group*" ShPK ka paraqitur argumenta lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues "*PEGASUS*" ShPK përsa i përket kualifikimit të ofertës së tij sipas parashikimeve të nenit 113 të Ligjit nr.162/2020 "*Për Prokurimin Publik*", i ndryshuar, të cilat janë protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 3478/2 prot., datë 10.12.2025.

II.8. Në datë 15.12.2025, autoriteti kontraktor nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave ka dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik shkresën nr. 3472/7 prot, datë 12.12.2025 "*Vendim KSHA 152/2025*", protokollluar me tonën me nr. 3478/3 prot, datë 15.12.2025, ku informon lidhur me vendimmarrjen e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës për trajtimin e

ankesës së operatorit ekonomik "*PEGASUS*" ShPK, në të cilin konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës nuk e ka pranuar ankesën e ankimuesit.

II.9. Me shkresën nr. 3472/8 prot, datë 15.12.2025 "*Mbi shqyrtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik "PEGASUS" shpk, lidhur me vlerësimin në procedurën e prokurimit me nr. REF-67459-11-03-2025, me objekt: 'Blerje pajisje laboratorike për Shërbimin e Laboratorit të Anatomo Patologjisë dhe Shërbimin e Bankës së Gjakut'.*", protokolluar me tonën me nr. 3478/4 prot, datë 16.12.2025, autoriteti kontraktor informon Komisionin e Prokurimit Publik lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues "*PEGASUS*" ShPK, në të cilin konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës me shkresën nr. 3472/7 prot, datë 12.12.2025 "*Vendim KSHA 152/2025*" nuk e ka pranuar ankesën e ankimuesit "*PEGASUS*" SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues "*PEGASUS*" ShPK, përsa i përket kundërshtimit të kualifikimit të ofertës së operatorit ekonomik "*Albadent Group*" ShPK në këtë procedurë prokurimi, si në vijim: "*Në bazë të të dhënave që kemi në lidhje me aparaturat që kjo kompani tregton dhe çmimit të ofruar në këtë procedurë, mendojmë se operatori nuk i plotëson të gjithë specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor, si më poshtë:*

1. Paisje për parafinizimin e indeve - 1 copë

Kapacitet ruajtes jo më pak se 300 kaseta indore dhe 280 kallëpe parafine standarte. Ndërfaqja e përdoruesit me ekran me prekje.

Të jetë i pajisur me zonë për mbajten e mjeteve të punë si pincetat 8-10 në madhësi të ndryshme.

Specifikimet e mësipërme gjykojmë që nuk plotësohen nga OE.

3. Arkiva e blloqeve të parafinës - 1 copë.

Kapaciteti minimal jo më pak se 30,000 kaseta parafine.

Të jetë e pajisur minimalisht me 10 nivele me 25 sirtare në secilin nivel.

Specifikimet e mësipërme kemi bindjen tonë që nuk plotësohen nga OE.

4. Arkiva e slideve - 1 copë.

Arkiva per ruajtjen e slideve duhet të jetë e lëvizshme.

Kapaciteti minimal 100,000 slide.

Të jetë e pajisur minimalisht me 10 nivele me 25 sirtare në secilin nivel.

Specifikimet e mësipërme kemi bindjen tonë që nuk plotësohen nga OE.

5. Paisje për ngjyrimin automatik të lamave - 1 copë.

Paisja të jetë e përbërë nga jo më pak se 26 stacione reagentesh lehtësisht të aksesueshme të cilat duhet të jenë mjaftueshëm për të realizuar disa protokolle ngjyrimi në të njëjtën kohë.
Të ofrojë stativ për mbajtjen e lamave (jo më pak se 10 copë), dhe jo më pak se 30 vasketa me kapacitet mbajtës të reagentit jo më pak se 300 ml dhe kapake plastike për mbulimin e vasketave që të shmanget avullimi i reagenteve.
Aparati të jetë i pajisur me filtra karboni dhe të jetë i shoqëruar me 5 sete back up të filtrave.
Paisja të përmbajë softuer të lehtë në përdorim që nëpërmjet opsione të ofruara të mundësojë përdorimin e paisjes në kapacitetin e sajë të plotë dhe gjithashtu të ofrojë opsionin e sistemit të kontrollit të cilësisë së reagenteve. Specifikimet e mësipërme gjykojmë që nuk plotësohen nga OE, ku devijime të tyre do krijonin impakt në përdorimin apo funksionalitetin e pajisjeve apo përdoruesin.
***7. Paisje për tharjen e slideve - 1 copë**.*
Paisja të jetë e ndërtuar nga treguesi dixhital i temperaturës dhe sipërfaqja e punës nga shufra të lëvizshme që mundësojnë vendosjen dhe tharjen e slideve.
Sipërfaqja e ngrohjes të jetë e veshur nga material që krijon kontast për vizualizimin e seksioneve të parafinës dhe gjithashtu veshje antimikrobiale.
Specifikimet e mësipërme gjykojmë që nuk plotësohen nga OE, ku devijime të tyre do krijoninn impakt në përdorimin apo funksionalitetin e pajisjeve apo përdoruesin.", Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 8 "*FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*" pika 2.3.6 "*Kapaciteti teknik*" të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt – ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriterin kualifikues si më poshtë:

"***2.3.6**. Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog/skedë teknike për artikujt objekt prokurimi, ku të përfshihen edhe specifikimet teknike te hollësishme, në mënyrë që të provohet pajtueshmeria me specifikimet teknike sipas dokumenteve të tenderit. Nëse katalogu/ët /skeda teknike janë në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip*.".

III.1.2. Në shtojcën 6 "*FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE*" të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt - ankimi autoriteti kontraktor ka përcaktuar specifikimet teknike të artikujve objekt prokurimi, si më poshtë:

Shtojca 6.

[Shtojcë për t'u plotesuar nga Autoriteti Kontraktor]
FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efiçencën e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;

b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;

c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Specifikimet teknike të pajisjeve objekt prokurimi janë si më poshtë vijon;

I. SPECIFIKIMET TEKNIKE

1. Paisje per parafinizimin e indeve – 1 copë

Sistem i integruar me modul parafinizues dhe modul ftohës, i paisur me veshje antimikrobiale.

*Kapaciteti i depozites se parafines jo me pak se 5 litra e pajisur me sistem filtrimi per parandalimin e futjes se mbetjeve te parafines ne shperndares**,** moduli ftohes me kapacitet minimal per akomodimin e 70 blloqeve.*

Kapacitet ruajtes jo me pak se 300 kaseta indore dhe 280 kallepe parafine standarte.

Te jete I pajisur me LED qe ndricon ne menyre uniforme siperfaqen e punes dhe qe ofron mundesine e rregullimit te nivelit te ndricimit.

Temperature e rregullueshme e modulit ftohes per te reduktuar plasaritjen e blloqeve indore me diapazon nga -13^{o}C deri ne – 2^{o}C

Te jete I pajisur me kontrollor manual per rregullimin e shperndarjes se parafines.

Te permbaje nje zone per heqjen e parafines se tepert nga kaseta

Ndërfaqja e përdoruesit me ekran me prekje.

Te jete I pajisur me zone per mbajten e mjeteve te pune si pincetat 8-10 ne madhesi te ndryshme.

*<u>*Argumentim teknik:</u>*

Ky diapazon prej 8-10 pinceta në madhësi të ndyshme është i domosdoshëm për të siguruar një efikasitet optimal të punës, siguri dhe adaptueshmeri në procedurat rutinë të histopatologjisë. Gjatë procesit të parafinizimit, tekniket përdorin shpesh pinceta të shumta për të manipuluar lloje të ndyshme të mostrave të indeve. Një kapacitet nën 6 pinceta do të kufizonte fleksibilitetin, do të ndërpsite rrjedhjen e punës dhe do të reduktonte produktivitetin për shkak të nevojës për ndryshime të shpeshta të instrumentave. Për më tepër sigurimi i

hapsirës për 8-10 pinceta minimizon rrezikun e kontaminimit. Ky kapacitet gjithashtu mbeshtet mjedise me shumë përdorues dhe eshte në përputheje me standartet e performacës së sistemeve të avancuara të parafinizimit. Prandaj ruajta e specifikimit prej 8-10 pinceta siguron përputhje me praktikat moderne labaratorike dhe garanton efikasitet dhe lehtesi përdorimi më të madhe.

2. Mikrotom – 1 copë

Paisje gjysme automatike
Te jete I pajisur me platforme mbajtese te qendrueshme te tehut preres per te realizuar prerje ne seksione parafine te nderlikuara
Te jete I pajisur me panel kontrolli me tastiere multi funksionale per te mundesuar kontrollin e shpejtesise, modaliteti dhe trashesin e seksionit indor.
Te ofrojme mundesine e prerjes se mostres pa kryer levizje te plote rrotulluese te mekanizmit te dores
Te ofroje opsionin e memories mbi pozicionin e seksionimit te meparshem
Te jete I pajisur me kontenitor mbetjesh te levizshem te mundesoje ndryshimin e pozicionit te panelit te kontrollit ne varesi te perdoruesit majtas ose djathtas.
Intervali i hapit te avancimit jo me pak se 28 mm
Trashesia minimale e seksionit indoor te perftuar te jete jo me shume se 0.5 µm
Retraktimi jo me shume se 40 µm
Fazat e prerjes mekanike ne intervalin 5-490 µm gjatesia e mbajteses se prehut preres jo me pak se 70mm per te lejuar prerjen e indit nga kaseta me permasa me te vogel/madhe se kaseta standarte

3. Arkiva e blloqeve te parafines – 1 cope

Arkiva per ruajtjen e blloqeve te parafines duhet te jete e levizshme
Kapaciteti minimal jo me pak se 30,000 kaseta parafine
Te jete e pajisur minimalisht me 10 nivele me 25 sirtare ne secilin nivel.

4. Arkiva e slideve – 1 cope

Arkiva per ruajtjen e slideve duhet te jete e levizshme
Kapaciteti minimal 100,000 slide
Te jete e pajisur minimalisht me 10 nivele me 25 sirtare ne secilin nivel.

5. Paisje per ngjyrimin automatik te lamave – 1 cope

Paisja te jete e perbere nga jo me pak se 26 stacione reagentesh lehtesisht te aksesueshme te cilat duhet te jene mjaftueshem per te realizuar disa protokolle ngjyrimi ne te njejten kohe.
Sistem i hapur per perdorim te te gjithe solucioneve nga kompani te ndryshme.
Te ofroje mundesine e prioritizimit te lamave urgjente pa kompromentuar lamat ne proces dhe mundesine e fillimit te zbatimit te procesit te punes ne hapa te caktuara te protokollit.
Te jete e pajisur me zone per tharjen e lamave e mjaftueshme per te perballuar volum te larte te punes

Te ofroje stativ per mbajtjen e lamave (jo me pak se 10 cope), dhe jo me pak se 30 vasketa me kapacitet mbajtes te reagentit jo me pak se 300 ml dhe kapake plastike per mbulimin e vasketave qe te shmanget avullimi i reagenteve.
Aparati te jete i pajisur me filtra karboni dhe te jete i shoqeruar me 5 sete back up te filtrave.
Paisja te permbaje softuer te lehte ne perdorim qe nepermjet opsione te ofruara te mundesoje perdorimin e paisjes ne kapacitetin e saje te plote dhe gjithashtu te ofroje opsionin e sistemit te kontrollit te cilesise se reagenteve.
**Argumetim teknik:*
1. Sistemi i kontrollit të reagentëve garanton siguri dhe gjurmueshmëri të lartë
Funksionaliteti i integruar i kontrollit të cilësisë së reagentëve është një garanci shtesë për cilësinë dhe sigurinë laboratorike, pasi pajisja:
monitoron në mënyrë të automatizuar lot-in, datën e skadencës, sasinë e mbetur dhe përdorimin e secilit reagent,jep alarme për mungesë ose skadencë, duke parandaluar përdorimin aksidental të një reagenti jo të vlefshëm, ofron gjurmueshmëri të plotë për çdo ngjyrim të realizuar, që është shumë e rëndësishme për auditim dhe akreditim sipas ISO 15189.
2. Ky funksion është në përputhje me praktikat më të avancuara laboratorike dhe standardet ndërkombëtare. Përdorimi i një sistemi të integruar për kontrollin e reagentëve është në linjë me zhvillimet e fundit në automatizimin dhe dixhitalizimin e proceseve laboratorike, ku qëllimi është:

- ✓ *minimizimi i ndërhyrjeve manuale,*
- ✓ *parandalimi i gabimeve njerëzore,*
- ✓ *dhe rritja e efikasitetit në laborator.*

Ky funksion eshte domosdoshmëri për laboratorët që kërkojnë të punojnë me standarde të larta dhe të jenë të përgatitur për auditime të jashtme.
3. Nxit cilësinë teknologjike
4. Përfitimet konkrete për laboratorin dhe pacientin:
Rritje e sigurisë diagnostike – përdoren vetëm reagentë të vlefshëm dhe të saktë.
Kursim kohe dhe burimesh – stafi nuk ka nevojë të bëjë regjistrime manuale të përdorimit të reagentëve.
Gjurmueshmëri e plotë për çdo ngjyrim, në rast hetimesh laboratorike, ankesa ose auditimi.
Zvogëlim i rrezikut të dështimit të analizës për shkak të reagentëve të skaduar ose të papërshtatshëm.

6. Paisje per shtrirjen e seksioneve indore te parafinizuara (banjo mari) – 1 cope
Paisje me temperature te kontrolluar e perbere nga treguesi dixhital i temperatures dhe nga depozita me thellesi minimale 70 mm dhe kapacitet 3-4 litra.
Te mundesoje zhytjen e slideve ne cdo kend te depozites per marrjen me lehtesi te seksionit te parafinizuar.
Siperfaqja e veshur me shtrese antibakteriale
Te jete e paisur me sistem per ngrohje te shpejte te ujit

7. Paisje per tharjen e slideve – 1 cope

Paisja te jete e ndertuar nga treguesi dixhital i temperatures dhe siperfaqja e punes nga shufra te levizshme qe mundesojne vendosjen dhe tharjen e slideve
Siperaqja e ngrohjes te jete e veshur nga material qe krijon kontast per vizualizimin e seksioneve te parafines dhe gjithashtu veshje antimikrobiale
Te jete I paisur me sistem per ngrohje te shpejte.

8. Termostat – 1 cope
Inkubator standard me konveksion te drejtuar
Intervali I temperatures: +7C deri ne +100 C
Te jete I pajisur me ekran LCD
Dera e brendshme te jete e perbere nga xham I temperuar
Te jete I pajisur me porte per USB
Kontroll elektromekanik per ajrin e shkarkuar
Volumi I brendshem ne intervalin 50-60 litra
**Argumentim teknik:*
Në shumicën e rasteve, një volum prej 50–60L është më se i mjaftueshëm për sasinë e mostrave që përpunohen.
Vëllimi i tepërt sjell konsum të panevojshëm të hapësirës, energjisë, si dhe kostove të mirëmbajtjes, pa ndonjë vlerë të shtuar

9. Inkubator per laboratorin e imunohematologjise- 1 copë
Një inkubator i cili arrin dhe mban temperaturën 37 gradë celcius në mënyrë kostante. për inkubimin e kartave që të ketë interval të modifikueshëm te kohës sipas nevojave të laboratorit për testimet imunohematologjike

10. Centrifugë për kartat me xhel – 1 copë
E përshtatshme për centrifugimin e kartës për testim imunohematologjik. Me nje kapacitet jo me pak se 10 karta.
Të jetë me ekran dixhitaë i cili të tregojë kohën e mbetur nga procesi dhe numrin e xhirove.
Xhirot të jenë të ndryshueshme e të arrinë të pakten 4000 rmp
Koha nga 0-99 minuta ose më shumë
Niveli i zhurmës jo më shumë se 55 db

Shënim: Për çdo çertifikatë,standart,markë,emër i veçantë,patentë,vizatim ose tip,origjinë specifike,prodhues ose sipërmarrës të përmendur më lart, pranohet edhe ekuivalenti i tyre.

III.1.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ofertës të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga operatori ekonomik "*Albadent Group*" SHPK, për përmbushjen të kriterit kualifikues të mësipërpërmendur, rezulton, se ky i fundit ka paraqitur në SPE dokumentacion si më poshtë vijon:

- *Dokumentin e emërtuar "Katalogu_Albadent_Group" ku gjenden katalogët e kompanive prodhuese "Ybo Technologies Co., Ltd" dhe "Labmate Scientific LLC" dhe konkretisht të modeleve të produkteteve të ofruara, si në vijim: "Modeli 'ES500',*

Modeli 'HS3355'. Modeli 'HS-CC01', Modeli 'HS-SC01", Modeli 'LSS-850'. Modeli 'HS1125', Modeli 'YBOTECH TXK4', Modeli 'LMSLD-A101', Modeli 'LMNO-B400' dhe Modeli 'LMBI-A102'.", modele të ofruara përkatësisht për artikjt objekt prokurimi me numër rendor si në vijim; "Nr.1, Nr.2, Nr. 3, Nr. 4, Nr. 5, Nr. 6, Nr. 10, Nr. 7, Nr. 8 dhe Nr. 9." Të përcaktuara në Shtojcën 6 "FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE" të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt - ankimi

- Dokumentin e emërtuar "Perkthime_Noterizime_Albadent_Group" *ku gjenden katalogët e kompanive prodhuese "Ybo Technologies Co., Ltd" dhe "Labmate Scientific LLC" të përkthyer dhe të noterizuar dhe konkretisht të modeleve të produkteteve të ofruara, si në vijim: "Modeli 'ES500', Modeli 'HS3355'. Modeli 'HS-CC01', Modeli 'HS-SC01", Modeli 'LSS-850'. Modeli 'HS1125', Modeli 'YBOTECH TXK4', Modeli 'LMSLD-A101', Modeli 'LMNO-B400' dhe Modeli 'LMBI-A102'.", modele të ofruara përkatësisht për artikjt objekt prokurimi me numër rendor si në vijim; "Nr.1, Nr.2, Nr. 3, Nr. 4, Nr. 5, Nr. 6, Nr. 10, Nr. 7, Nr. 8 dhe Nr. 9." Të përcaktuara në Shtojcën 6 "FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE" të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt – ankimi.*

III.1.4. Lidhur me pretendimet e parashtruara në ankesë nga ana e operatorit ekonomik "*PEGASUS*" SHPK, përsa i përket kundërshtimit të kualifikimit të ofertës së operatorit ekonomik "*Albadent Group*" SHPK Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës pranë autoritetit kontraktor me vendimin nr. *152/2025*, datë 12.12.2025, dërguar me shkresën nr. 3472/8 prot, datë 15.12.2025 "*Mbi shqyrtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik "PEGASUS" shpk, lidhur me vlerësimin në procedurën e prokurimit me nr. REF-67459-11-03-2025, me objekt: 'Blerje pajisje laboratorike për Shërbimin e Laboratorit të Anatomo Patologjisë dhe Shërbimin e Bankës së Gjakut'.*", protokolluar me tonën me nr. 3478/4 prot, datë 16.12.2025, nuk i ka pranuar këto pretendime të ankimuesit, duke argumentuar si në vijim: "*...Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave pasi mori në shqyrtim ankesën e paraqitur, për procedurën e prokurimit objekt ankimimi si dhe dokumentacionin e paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik nga operatori ekonomik "Albadent Group" shpk, konkretisht dokumentin me emërtesën "Katalogu Albadent_Group.pdf', konstaton përmbushjen e specifikimeve teknike konform Shtojcës 6 të dokumenteve të tenderit.*

Pas shqyrtimit të detajuar të katalogut teknik të paraqitur nga operatori ekonomik "Albadent Group" shpk, rezulton se dokumentacioni i ofruar përmban të giitha të dhënat thelbësore që mundësojnë konfrontimin me kërkesat e specifikimeve teknike të parashikuara në dokumentet e tenderit. Informacioni i paraqitur është i qartë, i strukturuar dhe përshkruan në mënyrë të plotë karakteristikat funksionale dhe teknike të produkteve/artikujve te kërkuar.

Së pari, nga analiza e karakteristikave kryesore teknike të listuara në katalog, vërehet se parametrat e përgiithshëm si kapaciteti funksional, dimensionet, performanca operative si dhe komponentët kryesorë përputhen me kërkesat minimale teknike të përcaktuara sipas specifikimeve teknike të hartuara nga Autoriteti Perfitues. Katalogu ofron përshkrime të

detajuara të secilit element përbërës, të cilat lehtësojnë verifikimin teknik të produkteve. Në katalog paraqiten gjithashtu ilustrime, foto, diagrame teknike dhe specifikime të brendshme të artikujve, të cilat e bëjnë të mundur verifikimin e plotë të përputhshmërisë...

Pra, Komisoni i Shqyrtimit të Ankesave, bazuar në shqyrtimin e plotë të katalogut të paraqitur nga ofertuesi, citon se të gjitha të dhënat teknike të dokumentuara përputhen me specifikimet e kërkuara nga dokumentet e tenderit. Katalogu është i qartë, i plotë dhe i mjaftueshëm për të vërtetuar se produktet/artikujt e ofruar i plotësojnë të giitha kushtet teknike minimale të kërkuara.

Në përfundim, duke u bazuar në shqyrtimin e plotë teknik të katalogut, si dhe në dispozitat ligjore të sipërpërmendura, konkludohet se operatori ekonomik "Albadent Group" shpk i përmbush plotësisht specifikimet teknike të kërkuara. Të gjitha elementët e dokumentacionit janë të verifikueshme, të qarta dhe në përputhje me kërkesat e dokumenteve të tenderit. Për rrjedhojë, vlerësimi i Komisonit të Vlerësimit të Ofertave konsiderohet i drejtë dhe oferta e paraqitur nga operatori ekonomik "Albadent Group" shpk është teknikisht e vlefshme dhe në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi për prokurimin publik.

Për sa më sipër, pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues nuk qëndron.

PËR KETO ARSYE

Bazuar ne Nenin 114 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", (i ndryshuar), si dhe Nenit 102 të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", (i ndryshuar), Komisioni i ngarkuar për shqyrtimin e ankesës,

VENDOSI

1. Refuzimin e ankesës se paraqitur nga operatori ekonomik "PEGASUS" shpk.
2. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë ankimuesin, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi.
3. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë operatorët ekonomikë të interesuar, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi.
4. Personi pergjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.
5. Ky vendim i njoftohet menjëherë Titullarit të Organit Qëndror Blerës.".

III.1.5. Në nenin 2 "*Qëllimi*" të ligjit nr.162/2022 *"Për Prokurimin Publik", i ndryshuar* parashikohet se:

"Qëllim i këtij ligji është:
a) të rrisë efiçencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;

c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.".

III.1.6. Neni 3 "*Parime të përgjithshme*" të ligjit nr.162/2022 *"Për Prokurimin Publik", i ndryshuar* parashikon se:

"*1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*
2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.".

III.1.7. Në nenin 76 "*Kriteret detyruese për skualifikim*", pika 3/a të ligjit nr. 162/2020 "*Për prokurimin publik",, i ndryshuar* përcaktohet se:

"*3. Çdo operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit nëse është në një nga situatat e mëposhtme:*
a) autoriteti ose enti kontraktor provon se ka shkelje të detyrimeve të zbatueshme që lidhen me legjislacionin për mbrojtjen nga diskriminimi, legjislacionin mjedisor, social, të punës, në fuqi apo me marrëveshjet kolektive dhe aktet e së drejtës ndërkombëtare në lidhje me këto fusha, ku Republika e Shqipërisë është palë;".

III.1.8. Në nenin 77, pikat 1 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se*:*

"1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:
a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
c) aftësinë teknike dhe profesionale.
Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.".

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se:

"3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji..."

III.1.9. Në nenin 40 "*Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave*", pika 6, e Vendimit Nr. 285, datë 19.05.2021, të Këshillit të Ministrave "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar, parashikohet se:

"*6. Autoriteti/enti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:*
a) Mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar, si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve, pas nënshkrimit të kontratës ose marrëveshjes kuadër, me kusht që kontrata në fjalë ose marrëveshja kuadër të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose
b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose
c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuara, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.".

III.1.10. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kritereve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e

përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.1.10. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit të procedurës objekt-ankimi, Komisioni konstaton se autoriteti kontraktor në kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.6 të Shtojcës 8 "*FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*" të dokumentave të tenderit ka kërkuar që operatorët ekonomikë ofertues për të gjithë artikujt objekt prokurimi duhet të dorëzojnë katalogë ose broshurë të artikujve të ofertuara me qëllim që të verifikohet nëse artikujt e ofertuar i përmbushin specifikimet teknike të artikujve objekt prokurimi të përcaktuara në Shtojcën 6 "*FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE*" të dokumentave të tenderit.
Sa më sipër, nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues të përmendura në pikën III.1. të këtij vendimi dhe dokumentacionit të ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ofertues "*Albadent Group*" SHPk në sistemin e prokurimeve elektronike për përmbushjen e kriterit të mësipërm, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se ky i fundit ka paraqitur dokumentacionin e përcaktuar në pikën III.1.3. të këtij vendimi, ku për disa nga artikujt objekt prokurimi dhe konkretisht për artikujt objekt prokurimi si në vijim: "***Nr. 1*** *'Paisje për parafinizimin e indeve',* ***Nr. 3*** *'Arkiva e blloqeve të parafinës',* ***Nr. 4*** *'Arkiva e slideve',* ***Nr. 5*** *'Paisje për ngjyrimin automatik të lamave' dhe* ***Nr. 7*** *'Paisje për tharjen e slideve'.*"
ka ofertuar përkatësisht modelet si në vijim: "*Modeli 'ES500', Modeli 'HS-CC01', Modeli 'HS-SC01' dhe Modelin 'LSS-850'.",* produkte të kompanisë prodhuese *"Ybo Technologies Co., Ltd",* si dhe modelin si në vijim; "*Modeli 'LMSLD-A101'.*", produkt të kompanisë prodhuese *"Labmate Scientific LLC",* ku nga shqyrtimi i skedave teknike të këtyre produkteve konstatohet si në vijim: "*Modeli 'ES500' i ofruar nuk plotëson specifikimet teknike si në vijim: "Kapacitet ruajtes jo më pak se 300 kaseta indore dhe 280 kallëpe parafine standarte dhe Të jetë i pajisur me zonë për mbajten e mjeteve të punë si pincetat 8-10 në madhësi të ndryshme.", të përcaktuara nga ana e autoritetit kontraktor për produktin objekt prokurimi Nr. 1 'Paisje për parafinizimin e indeve' të përcaktuara në Shtojcën 6 "FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE" të dokumentave të tenderit*; *Modeli 'HS-CC01' i ofruar nuk plotëson specifikimin teknik si në vijim: "Të jetë e pajisur minimalisht me 10 nivele me 25 sirtare në secilin nivel", të përcaktuar nga ana e autoritetit kontraktor për produktin objekt prokurimi Nr. 3 'Arkiva e blloqeve të parafinës' të përcaktuar në Shtojcën 6 "FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE" të dokumentave të tenderit; Modeli 'HS-SC01' i ofruar nuk plotëson specifikimin teknik si në vijim: "Të jetë e pajisur minimalisht me 10 nivele me 25 sirtare në secilin nivel", të përcaktuar nga ana e autoritetit kontraktor për produktin objekt prokurimi Nr. 4 'Arkiva e slideve' të përcaktuar në Shtojcën 6 "FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE" të dokumentave të tenderit; Modeli 'LSS-850'' i ofruar nuk plotëson specifikimin teknik si në vijim: "Aparati te jete i pajisur me filtra karboni dhe te jete i shoqeruar me 5 sete back up te filtrave", të përcaktuar nga ana e autoritetit kontraktor për produktin objekt prokurimi Nr. 5 'Paisje për ngjyrimin automatik të lamave' të përcaktuar në Shtojcën 6 "FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE" të*

dokumentave të tenderit, si dhe Modeli 'LMSLD-A101' i ofruar nuk plotëson specifikimin teknik si në vijim: "Sipërfaqja e ngrohjes të jetë e veshur nga material që krijon kontast për vizualizimin e seksioneve të parafinës dhe gjithashtu veshje antimikrobiale", të përcaktuar nga ana e autoritetit kontraktor për produktin objekt prokurimi Nr. 7 'Paisje për tharjen e slideve të përcaktuar në Shtojcën 6 "FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE" të dokumentave të tenderit.".

Nisur nga sa më sipër, Komisioni gjykon se operatori ekonomik ofertues "*Albadent Group*" SHPK me dokumentacionin e ofertës së dorëzuar nuk e plotëson kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.6 "*Kapaciteti teknik*" të shtojcës 8 "*FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*" të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt – ankimi, pasi produktet e ofruara për produktet objekt prokurimi si në vijim; "***Nr. 1*** *'Paisje për parafinizimin e indeve',* ***Nr. 3*** *'Arkiva e blloqeve të parafinës',* ***Nr. 4*** *'Arkiva e slideve',* ***Nr. 5*** *'Paisje për ngjyrimin automatik të lamave' dhe* ***Nr. 7*** *'Paisje për tharjen e slideve'.*", nuk plotësojnë specifikimet teknike të këtyre produkteve të përcaktuara nga ana e autoritetit kontraktor në Shtojcën 6 "*FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE*" të dokumentave të tenderit.

Komisioni thekson, se operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike/kritereve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi.

Sa më sipër arsyetuar Komisioni gjykon, se pretendimi i operatori ekonomik ankimues "*PEGASUS*" SHPK qëndron pjesërisht, pasi operatori ekonomik ofertues "*Albadent Group*" SHPK me dokumentacionin e dorëzuar nuk provon se përmbush kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.6 "*Kapaciteti teknik*" të Shtojcës 8 "*FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*" të dokumentave të tenderit, pasi produktet e ofruara për produktet objekt prokurimi si në vijim; "***Nr. 1*** *'Paisje për parafinizimin e indeve',* ***Nr. 3*** *'Arkiva e blloqeve të parafinës',* ***Nr. 4*** *'Arkiva e slideve',* ***Nr. 5*** *'Paisje për ngjyrimin automatik të lamave' dhe* ***Nr. 7*** *'Paisje për tharjen e slideve'.*", nuk plotësojnë disa specifikimet teknike të këtyre produkteve të përcaktuara nga ana e autoritetit kontraktor në Shtojcën 6 "*FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE*" të dokumentave të tenderit, të konstatuara më sipër.

Sa më lart, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues "*PEGASUS*" SHPK qëndron pjesërisht.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 "*Për Prokurimin Publik*", i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për*

miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 "Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik", Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 "*Për miratimin e rregullave "Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*", Nenit 4, te Vendimit te Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 "*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*" Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik "*PEGASUS*" ShPK në procedurën e prokurimit *"E hapur e thjeshtuar*", me numër reference Nr. *REF-67459-11-03-2025*, me objekt: "*Blerje pajisje laboratorike për Shërbimin e Laboratorit të Anatomo Patologjisë dhe Shërbimin e Bankës së Gjakut",* me fond limit 9,371,546.33 (*nëntë milion e treqind e shtatëdhjetë e një mijë e pesëqind e dyzet e gjashtë pikë tridhjetë e tre*) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 14.11.2025, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara Sh.A.

2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi kualifikimin e operatorit ekonomik "*Albadent Group*" SHPK, duke e skualifikuar këtë operator ekonomik.

3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.

4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik "*PEGASUS*" SHPK

5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.

6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Digitally signed by
Fiorent ZGURO
Date: 2026.01.09
01:12:37

Vulosur elektronikisht nga Komisioni i Prokurimit Publik
Date:2026/01/09 11:03:57 +02'00'
e3fc005ae059437393b6894827899f68

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një proçedure automatike nga një sistem elektronik (Komisioni i Prokurimit Publik)